



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit (Glllogoc)
Kuvendi i Komunës

02 Nr. 353/01-9925 dt. 29.02. 2024



Bazuar në nenin 11,12,dhe 40 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 34 paragrafi të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 26 të Rregullorës (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, neni 15 dhe 16 i Ligjit nr.04/L-174 për Planifikim Hapësinor, Planit Zhvillimorë Komunal i Glllogocit 2020-2028, pika 13.2 Hartës Zonale të Komunës së Glllogocit, Vlerësimi i Ligjshmërisë nr.12-548—2/24, Kuvendi i Komunës së Drenasit (Glllogoc) në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë: 29.02.2024, miratoi këtë:

V E N D I M

Për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit 02-353/01-5031 dt.29.01.2024 për caktimin e lokacionit për realizimin e projektit për ndërtimin e objekteve të çerdheve në Tërstenik dhe Nekoc

I.

MIRATOHET propozimi për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit nr.02-353/01-5031 të dt.29.01.2024 për caktimin e lokacionit për realizimin e Projektit për ndërtimin e objekteve të qerdheve nga ana e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit – MASHTI në fshatin Tërstenik dhe Nekoc.

II.

Me këtë vendim do të plotësohet dhe ndryshohet pjesa hyrëse, neni II dhe neni III i vendimit nr.02-353/01-5031 i dt. 29.01.2024.

Pjesës hyrëse do t'i shtohet edhe pjesa si në vijim: nenit 26 të Rregullorës (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, neni 15 dhe 16 i Ligjit nr.04/L-174 për Planifikim Hapësinor, Planit Zhvillimorë Komunal i Glllogocit 2020-2028, pika 13.2 Hartës Zonale të Komunës së Glllogocit, Vlerësimi i Ligjshmërisë nr.12-548—2/24.

Në nenin II dhe III do të ndryshohen fjalët tokë ndërtimore me fjalët 'shërbime arsimore', ndërsa pjesa tjetër mbetet e pa ndryshuar.

III.

Bazë për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit nr.02-353/01-5031 të dt.29.01.2024 për caktimin e lokacionit për realizimin e Projektit për ndërtimin e objekteve të çerdheve nga ana e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit – MASHTI në fshatin Tërstenik dhe Nekoc, është kërkesa për ligjshmëri nr.12-548-2/24 e dt.09.02.2024, e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

IV.

Obligohet Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë, që të përfundoj të gjitha procedurat e nevojshme gjeodozike, kadastrale dhe pronësore, që nevojiten për regjistrimin në RDPP.

V.

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë e Komunës së Drenasit.

VI.

Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë: skicat, kopjet e planit dhe certifikatat e njësive kadastrale.

VII.

Me këtë Vendim do të njoftohen organet kompetente të Komunës së Drenasit.

VIII.

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit ;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Milaim Hajdari

A r s y e t i m

Bazë për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr.02-353/01-5031 të dates 29.01.2024, është kërkesa për ligjshmëri e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, nr.12-548-2/24 e dt.09.02.2024, e cila ka kërkuar rishqyrtimin e ligjshmërisë së vendimit të lartë cekur, ku ka kërkuar harmonizimin e këtij vendimi me dokumentet e planifikimit hapësinorë sipas ligjit nr.04/L-174 për Planifikim Hapësinorë.

Sipas kërkesës së MASHTI-së e cila edhe është donator i këtij projekti, punimet për ndërtimin e objekteve të çerdheve pritet të fillojnë shumë shpejt, andaj për tu kryer punët sipas standardeve të kërkuara është e domosdoshme të miratohet ky vendim dhe të caktohet lokacioni i shënuar më lartë, për arsye të realizimit të projektit për ndërtimin e objekteve të çerdheve.

Pra projekti për ndërtimin e objekteve të çerdheve në zonën kadastrale Tërstenik dhe Nekoc, do të financohet nga MASHTI, vlenë të ceket se në parcelen 175-0 është ndërtuar edhe shkolla fillore 'Zenel Hajdini', gjithashtu edhe në parcelat 365-0 dhe 364-2 është ndërtuar shkolla fillore 'Bajram Curri', si dhe parcela 364-1 është në kufi me parcelen 364-2, prandaj edhe është zgjedhur ky lokacion për ndërtimin e çerdheve .

Drejtorati për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë ka caktuar ekipin profesional i cili ka përcaktuar dhe ka bërë matjet gjeodezike të lokacioneve për ndërtimin e çerdheve në Tërstenik dhe Nekoc, sipas kërkesës së DA-së ka përgaditur dokumentet e nevojshme gjeodezike.

Parcelat P-70315071-00175-0, P-70314053-365-0, P-70314053-364-1 dhe P-70314053-364-2, dhe sipas Planit Zhvillimor Komunal 2020-2028 me nr. dhe Hartës Zonale janë planifikuar për Shërbim të komunitetit - Shërbim Arsimor.

Të dy lokacionet e planifikuara për ndërtimin e çerdheve sipas Hartës Zonale të Komunës së Glllogocit 2022-2030, janë të planifikuara të shfrytëzohen për Shërbim Arsimor (Hilucs 3.3.2).

Rrjedhimisht, Në duke u bazuar në pjesë tekstuale (faqe 185) të këtij dokumenti zona është planifikuar të shfrytëzohet si në vijim:

Hapësira të shfrytëzuara për ofrimin e shërbimeve të arsimit parashkollore, shkollore dhe universitar dhe shërbime të tjera arsimore.

Në pjesën grafike të Hartës Zonale të Komunës së Glllogocit 2022-2030, poashtu këto lokacione janë të planifikuara brenda zonës Shërbim i komunitetit – Shërbim Arsimor.

Të bashkëngjitur gjeni hartat e shfrytëzimit të tokës sipas HZk-së për lokacionet e propozuar për çerdhe.

Pjesë përbërse e këtijë propozim-vendimi janë edhe Certifikatat mbi të drejtat e pronës, kopjet e planit dhe skicat e propozuar për lokacione dhe vlerësimi i ligjshmërisë nr.12-548-2/24



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLICA OF KOSOVO / РЕПУБЛИКА КООСОВА	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTRI I JEVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Nr./Pika orig. Org./Jedësia Org./Unit	02
Nr./Faqe Bë./Stranica No./Pages	02
Nr./Pika Bë./Pika Prod./No	1279-2/24
Data Datume Date	12.03.24
PRISHTINË / A	
No. 1	

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Për:	Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Glllogocit Milaim Hajdari, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Glllogocit
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL Jeton Qela, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL
Përmes:	Liburn Aliu, Ministër i MMPHI Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI
Nga:	Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor
Zyrtarët përgjegjës: 1.Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor 2.Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	
Lënda:	Vlerësimi i ligjshmërisë
Lloji i aktit:	Vendimi 02. Nr. 353/01-9925 për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit Nr. 02-353/01-5031 për caktimin e lokacionit për realizimin e projektit për ndërtimin e objekteve të çerdheve në Tërstenik dhe Nekoc, miratuar nga Kuvendi Komunal i Glllogocit, datë 29.02.2024.

I nderuar kryetar Lladrovci,
I nderuar kryesues Hajdari,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me datë 01.03.2024, ka pranuar nga MAPL Vendimin 02. Nr. 353/01-9925 për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit Nr. 02-353/01-5031

për caktimin e lokacionit për realizimin e projektit për ndërtimin e objekteve të çerdheve në Tërstenik dhe Nekoc, miratuar nga Kuvendi Komunal i Glllogocit, datë 29.02.2024.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim me Nenin 4 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, konstaton se:

Për nxjerrjen e Vendimit 02. Nr. 353/01-9925 për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit Nr. 02-353/01-5031 për caktimin e lokacionit për realizimin e projektit për ndërtimin e objekteve të çerdheve në Tërstenik **nuk jemi kompetent** për të bërë vlerësimin e ligjshmërisë, duke u bazuar në pikën 2 të Shojcës II të Rregullores (QRK) Nr.06/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave.